



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/04/22

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga pala F.R, ndaj gjyqtarit B.M, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 26.01.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga pala F.R, për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.M, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykatë – Kryetarja e Gjykatës A.Sh R me datë 30.12.2021 nga F.R, ka pranuar ankesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B.M.

Parashtruesi F.R, ka ushtruar ankesë lidhur me zvarritjen e procedurës në lëndën e çështjes ekonomike ndaj gjyqtarit B. Miftari, duke theksuar se bëhen gati tri (3) vite që po pres të filloi gjykimi dhe po vërej që nuk ka një angazhim të tillë nga organi për mënyrën si është zvarritur procesi deri më tani.

Gjyqtari B.M ka deklaruar se lënda e evidentuar sipas numrit **LEK.Nr.473/19** është në punë në zyrën time dhe është duke u proceduar konform rregullativës ligjore procedurale. Lënda është me investitorë të Huaj dhe si e tillë është më e vështirë për tu proceduar dhe merr më shumë kohë dhe energji, sesa lëndët e tjera të Departamentit Ekonomik. Po ashtu, është proceduar dhe lidhur me masën e sigurimit të propozuar nga pala paditëse dhe është në vazhdim të procedimit me lëndën.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese dhe pas vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore të gjyqtarit B.M.

Autoriteti i kësaj gjykate, referuar të dhënave në shkresa nuk ka gjet se ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore. Lënda e çështjes ekonomike IEK.nr.473/19 është pranuar në Departamentin Ekonomik të kësaj gjykate me datë 19.08.2019, e cila lëndë në fillim i është caktuar gjyqtarës F.ZH., me datë 17.09.2019 i është dorëzuar gjyqtarit B. Miftari. Gjyqtari në këtë lëndë ka marr veprime në procedim të të njëjtës dhe është në vazhdim të procedimit të saj. Ndërsa çështja e vonesës që merr kohë për njoftimin me post të paditurve, shpallja në faqen zyrtare, pastaj posta që nuk e ka gjet adresën e avokatit të palës, janë shkaqe objektive dhe nuk konsiderohen shkelje disiplinore nga gjyqtari i çështjes ekonomike.

Andaj, Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar KGJK-së kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/04/22, më datë 26.01.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë